



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.1129/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Fejzullah Rexhepi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, për shkak të parregullsive në ditën e votimit për Rivotim, në Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 17.12.2017, për Kryetar të Komunës së Istogut, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 19.12.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohen si të pabazuara ankesat e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, dega në Istog, ZL.Anr. 1129/2017, ZL.Anr. 1133/2017, ZL.Anr. 1140/2017 dhe ZL.Anr. 1141/2017 të datës 18.12.2017, me të cilat ka kërkuar që të ndërmerren masa ndaj personave që i kanë shkaktuar parregullsitë, në ditën e votimit të datës 17.12.2017.

A r s y e t i m

Më datën 18.12.2017, PZAP-i, ka pranuar ankesat me numër ZL.Anr 1129/2017, ZL.Anr. 1133/2017, ZL.Anr.1140/2017, ZL.Anr.1141/2017 të datës 18.12.2017, të parashtruara nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me të cilën pretendohet se ka pasur parregullsi gjatë ditës së rivotimit për Kryetar Komune në Istog ashtu që:

- Në ankesën ZL.Anr 1129/2017, është pretenduar se Selajdin Bytyqi, ka dhënë mito dhe ka bërë presion ndaj votueseve në Qendrën e Votimit 0601C, më tej parashtruesi i ankesës thekson se Zize Bujupaj, e cila është Drejtoresh në Departamentin e Prokurimit në Komunën e Istogut, ka penguar procesin zgjedhor duke manipuluar me votuesit për kundër faktit se e njëjta nuk ka qenë e certifikuar nga KQZ-ja. Kjo parregullsi është raportuar edhe në dhomën operative në KQZ.

- Në ankesën ZL.Anr 1133/2017, është pretenduar se vëzhguesi i subjektit politik AAK, ka vërejtur, se anëtarja e LDK-së Zize Bujupi, ka bërë presion të votuesit për ta votuar subjektin politik LDK në Qendrën e Votimit 0601C. Me propozim për panelin që të ndërmerren masat ligjore.

- Në ankesën ZL.Anr 1140/2017, është pretenduar se tre persona janë intervistuar për dhënie dhe marrje të ryshfetit gjatë procesit zgjedhor, në Komunë e Istogut, sipas parashtruesit të ankesës Selajdin Bytyqi, kandidatët i LDK-së, për asamble komunale është arrestuar dhe është liruar ndërsa dy persona tjerë kanë vazhduar gjatë gjithë ditën blerjen e votave. Dhe kërkon nga paneli që të heton rastin në fjalë dhe të ndërmarrë të gjitha masat në fjalë.

- Në ankesën ZL.Anr 1141/2017, pretendohet se për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, është arrestuar Selajdin Bytyqi, për shkak se i njëjti ka bërë blerje të votave. Me propozim për panelin që të ndërmerren masat ligjore.

Në përgjigjet në ankesë nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e datës 19.12.2017, theksohet se ankesat e subjektit politik AAK, janë të pabazuara dhe tendencioze me prova të fabrikuara. Më tej subjekti politik LDK, në përgjigje në ankesë, ka theksuar se Selajdin Bytyqi, nuk është arrestuar duke blerë vota e as duke dhënë mito por thjesht pas një pretendimi që është ngritur nga dikush ky person është ftuar në polici, ka shkuar vullnetarisht dhe ka dhënë deklaratën sipas të cilës pretendimi në fjalë e ka mohuar në tërësi. Lidhur me deklaratën e dhënë nga Nexhmedin Balaj LDK në përgjigjen në ankesë ka theksuar se deklarata është plotësisht e pavërtetë sepse nuk ka pasur ndonjë rast që të jetë raportuar se dikush, aq më tepër një zonjë siç është Zize Bujupaj, mund të shtyhej me forcë dikë që të votoj në një mënyrë të caktuar. Zize Bujupaj ka qenë vëzhguese e certifikuar nga ana e KQZ-së dhe e njëjta ka kryer detyrat e saj të vëzhgueses dhe asgjë më tepër. Poashtu në përgjigje në ankesë subjekti politik LDK, thekson se Nexhmedin Balaj në qendrën për të cilën ofron dëshmi nuk është as pjesë e ndonjërit Këshill të VV në QV 0601c, as vëzhgues e as nuk voton në këtë qendër, prandaj del se ky person nuk ka asnjë lidhje me këtë QV, prandaj është e paqartë se për çfarë arsye ka qëndruar ky vet në këtë QV duke qenë se ai është asamblist i zgjedhur në Zgjedhjet e fundit nga radhët e AAK-së. Me propozim për panelin që ankesat të refuzohen si të pabazuara.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8 par.3 të Rregullave dhe Procedurat te PZAP-it, ka bashkuar ankesat dhe i ka trajtuar si një ankesë të evidentuar me ZL Anr. 1129/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

PZAP-i, pas shqyrtimit të ankesave, pretendimeve ankimore, dhe provave shkresore që gjenden në ankesa, në kuptim të nenit 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë te pabazuara

Paneli në kuptim të nenit 14 të Rregullës Nr.02/2015 të PZAP-it ka zhvilluar hetimet në këtë rast dhe nëpërmjet telefonit zyrtar ka kontaktuar me Nexhmedin Bytyqi menaxher i Qendrës së Votimit 0601C, i cili thekson se pretendimet në ankesat e bëra nga subjekti politik AAK nuk qëndrojnë pasi që në objektin e kësaj shkolle dhe në hapësirën e kësaj shkolle brenda dhe jashtë nuk ka pasur probleme përkitazi me pretendimet e pohuara në ankesë. Deklaratën e dhënë nga Nexhmedin Balaj e cilëson si pa ndikim për faktin se ai nuk ka qenë votues i kësaj qendre votimi dhe nuk ka pasur të drejtën të qëndrojë në atë Qendër të Votimit, pasi që

është votues në fshatin Llukar. Në mënyrë shoqërore ka kërkuar si menaxher Nexhmedin Balaj të largohet po ai prap është kthyer duke incizuar në telefon dhe kur e ka pyetur se pse bën inqizime ai ka theksuar se:” znj. Ziza po blen vota”. Po ashtu e njëjta ka pohuar se janë të pavërteta pretendimet në ankesë se znj.Ziza Bujupaj, ka penguar procesin zgjedhor, pasi që ajo pas votimit menjëherë është larguar. Po ashtu ka pohuar se janë të paqëndrueshme pretendimet në ankesë se Selajdin Bytyqi ka blerë vota, për faktin se brenda kësaj qendre të votimit si dhe hapësirës përreth nuk ka pa të ketë ndodhur ndonjë veprim i tillë.

Nga raporti i Policisë së Kosovës me numër 2017-DF-376 i datës 17.12.2017, paneli konstaton se të dyshuarit pasi që e kanë sjellë familjen e tyre për të votuar, dyshohet se kanë pranuar mjetet financiare në vlerë prej 5 euro, të cilët janë shoqëruar në Stacionin Policor në Istog, ku janë intervistuar në cilësinë e të dyshuarve. Pas intervistimit me urdhër të prokurorit të shtetit, rasti është proceduar në procedurë të rregullt dhe palët janë liruar. Por nga raport nuk mund të vërtetohet se kemi të bëjmë me parregullsi të cilat do ta minoni procesin e rregullt zgjedhor, ndërsa pretendimet se është marrë mito në bazë të këtij raporti janë vetëm dyshime.

Paneli pas vlerësimit të pretendimeve në ankesa, provave të lartpërmendura erdhi në përfundim, se parashtruesi i ankesave me asnjë provë nuk i ka bërë besueshme pretendimet e tij se parregullsitë e pretenduar në ankesat për të cilat është vendosur në dispozitiv të këtij vendimi, e kanë cenuar integritetin e procesit të votimit dhe kanë pas ndikim në votues për të votuar subjektin e caktuar politik.

Prandaj, ankesat konsiderohen si të përgjithësuara dhe të pa argumentuara me fakte dhe si të tilla jo bindëse pasi që nuk i plotësohen kërkesat ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit 117 të LZP-së.

Rrjedhimisht PZAP-i në mungesë të provave dhe dëshmive konkrete dhe bindëse për pretendimet e paraqitura në ankesa, konstaton se ankesat në fjalë janë të pabazuar dhe të pa argumentuar dhe si të tilla ankesat i refuzoj si të pabazuar.

Për hetime të mëtejshme lidhur me elementet e veprës penale në këtë rast konkret, paneli duke u bazuar nën 3 par.11 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, me Nr.02/2015, lëndën do ta dërgon në Prokurorinë e Shtetit


Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në mbështetje të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.1129/2017 me datën 19.12.2017

Kryesues i Panelit

Fejzullah Rexhepi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi Gjykatës Supreme të Kosovës.